



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi lënien në fuqi të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 212, nr. 213 dhe nr. 214, datë 15.12.2020.
2. “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022”.
3. Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., për vitin 2022.
4. Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a. për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020.
5. Mbi miratimin e Licencës TIP për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNLsë.
6. Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
7. Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kamican” me kapacitet të instaluar 1860 kW.
9. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW.
10. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për tranferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.